



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK



V E N D I M

Nr. 29, date 20.05.2019

PËR PLOTËSIMIN E VAKANCËS DHE DHËNIEN E MANDATIT TË
KËSHILLTARIT BASHKIAK Z. LUSH MARKU

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e datës 20.5.2019, me propozim të komisionit të mandateve, në mbështetje të neneve 49 pika 1, 54 shkronja “j”, 55 pika 3 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, nenit 164 të Kodit Zgjedhor, të ndryshuar, vendimit nr. 962, datë 28.07.2015 të KQZ-së “Për shpërndarjen e mandateve për Këshillin e Bashkisë Shkodër, Qarku Shkodër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015”, shkresës nr. 2826 prot, datë 8.5.2019 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve “Njoftim për vazhdimin e procedurave për dhënien e mandatit”, listës shumemërore “Për kandidatët për këshillin bashkiak Shkodër për zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015” të subjektit Partia Socialiste e Shqipërisë,

V E N D O S I

1. Plotësimin e vakancës dhe miratimin e dhënies së mandatit të anëtarit të këshillit bashkiak Shkodër z. **Lush Kol Marku**, si kandidat i radhës me numër rendor 11, në listën shumemërore të Partisë Socialiste të Shqipërisë “Për anëtarë të këshillit bashkiak Shkodër, në zgjedhjet për organet e qeverisjes vendore të datës 21.06.2015”.
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet sekretari i këshillit bashkiak.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Miratuar në datën 20.5.2019

Shpallur në datën 20.5.2019

Sekretar i këshillit

Suel Hadri

KRYETAR

Xhemal BUSHATI